



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 19.12.2023, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Sllavisa Trajkovic
8. Idajet Graip
9. Olga Gucic

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
2. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
3. Përfaqësues të OSBE-së

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha i uroj mirëseardhje anëtares se re Olga Gucic duke i uruar punë të mbarë dhe suksese, pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e 20-te
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
3. Të ndryshme.

I

Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 19-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstrakteve nga mbledhja 19 -të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

Pastaj Kryesuesi i komitetit tha se po kalojmë në pikën në vijim.

II

Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, tha se bashku me sektorin e kuvendit ua kemi dërguar draft planin. Vitin e kaluar ka qen një plan i mire te cilin e kemi shqyrtuar ne përpikëri dhe shpresojmë qe edhe këtë vit te vazhdojmë me te njëjtin mënyre.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se vitin e kaluar ka qen një plan i mire te cilin e kemi zbatuar ne tersi, e kam një propozim qe sikur vitin e kaluar edhe këtë vit te raportoj ZLK-ja, çdo 2 muaj. Po ashtu tha se e falënderojë dhe nënkryetarin e komunës për bashkëpunimin qe kemi pas.

Lulzim Qerimi, tha se edhe unë ju falënderoj për bashkëpunimin dhe punën qe keni bërë. Unë mendoj qe ZLK-ja, duhet te raportoj çdo muaj ne mënyre qe ju si komitet te njoftoheni me aktivitetet qe do te bëhen apo për ndonjë çështje tjetër.

Zoran Cikrovic, tha se edhe unë pajtona qe ZLK-ja, duhet te raportoj çdo muaj ne mënyrë qe te jemi sa me te informuar për aktivitetet dhe punët e tyre.

Shahadije Bikilqi, tha se edhe unë jam e pajtimin qe për çdo muaj te raportoj ZLK-ja, po ashtu edhe nënkryetari i komunës te marr pjese ne mbledhje çdo here.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë e mbështes këtë plan ashtu si e shohin shumica me te arsyeshme pasi qëllimi ynë është qe sa me shume ti mbrojmë te drejtat e komuniteteve.

Pastaj kryesuesi e hodhi ne votim planin e punës se komitetit me rekomandimet e marra nga anëtarët e komitetit. Dhe pas votimit aprovoi Planin e Punës për vitin 2024

Pastaj u kalua ne piken te ndryshme.

III

Të ndryshme

Skender Bikliqi, kryesues i komitetit tha se pari ju falënderoj te gjithëve për bashkëpunimin qe kemi pas duke filluar nga nënkryetari i komunës anteritë e komitetit përfaqësuesit e OSBE-se, përfaqësuesit e UNMIKUT, sektori i kuvendit, ku ka qen një vit shumë i mire dhe jemi munduar bashkërisht qe te punojmë për te mirën e komuniteteve. Po ashtu tha se ua uroj festa e fund vitit te gjithëve duke ju uruar se pari shëndet pune te mbare dhe bashkëpunim edhe me te mire ne vitin tjetër.

Zoran Cirkovic, tha se edhe unë ju falënderoj te gjithëve për bashkëpunimin dhe punën qe kemi bere për te mirën e komuniteteve. Po ashtu e falënderoj edhe nënkryetarin e komune qe ka marr pjese ta takime çdo here e ku i ka dhëne edhe me shume seriozitet

këtij komiteti. Po ashtu dhe plani ka qene shume i mirë dhe gjithëpërfshirës dhe e mbështes. Po ashtu i falënderoj edhe anëtarët e komitetit qe janë përfaqësues ne kuvend për kërkesat qe i kanë ngritur ne kuvendet ta dalura nga komiteti. Si shqetësim mbetet rruga te cilën e kam ngritur disa here për fshatin Gracke qe ka qene dhe premtim i drejtorit te infrastrukturës ne mbledhje te komitetit e e cila për fat te keq nuk është rregulluar. Edhe unë ju uroj festa e fundi vitit duke ju uruar suksese dhe pune te mbarë.

Meqë çështje të tjera nuk pati vizita përfundoi në ora 15⁰⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi